REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1595/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 05.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 pargrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 7 të Rregullores (KKV) nr. 04/20, prot. nr. 95/20, datë 28.05.2020 për Ndarjen e Bursave për Studentë Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës, Kryetari i Komunës me datën 05.12.2022 merr këtë:

# VENDIM

1. Me këtë vendim lejohet ndarja e bursave për vitin shkollor 2022/2023 për njëzet (20) nxënës të SHMT "Lutfi Musiqi" në Vushtrri të klasës së 10-të, profilet: Metalpunues dhe Përpunues i Drurit,

2. Shuma e bursës për secilin nxënës është dyqind e pesëdhjetë euro (250.00 €).

3. Zbatimin e këtij vendimi do t'a bëj Drejtoria për Arsim, konform Rregullores (KKV) nr. 04/20, prot. nr. 95/20, datë 28.05.2020 për Ndarjen e Bursave për Studentë Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:
- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1605/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 07.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 pika 14 të Statutit të Komunës, nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS

1. Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të komunës (inventari i administratës së komunës) në këtë përbërje:
   1.1 **Vlora Krasniqi**, kryesuese
   1.2 **Rexhep Gërguri,** anëtar
   1.3 **Shqipe Gashi** anëtar

2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në administratën e komunës në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht Rregullën për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014.

3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj inventarizimin para përfundimit të vitit kalendarik 2022.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për buxhet dhe financa,
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 16 06 / 22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 07.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 pika 14 të Statutit të Komunës, nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE NË ARSIMIN PUBLIK

1. Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të Arsimit publik në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
   **1.1** Enver Bajrami, kryesues
   **1.2** Hashim Hajrizi, anëtar
   **1.3** Musaj Tërbunja, anëtar

2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të arsimit të komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht Rregullën për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014.

3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj inventarizimin para përfundimit të vitit kalendarik 2022.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË II OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVO

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1607/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 07.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 pika 14 të Statutit të Komunës, nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE NË SHËNDETËSI

**1** Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në institucionet e shëndetit publik të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- **1.1** Fatmire Krasniqi, kryesuese
- **1.2** Fisnik Kamberi, anëtar
- **1.3** Ferit Ibishi, anëtar

**2** Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht Rregullën për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014.

**3** Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj inventarizimin para përfundimit të vitit kalendarik 2022.

**4** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1661/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 19.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dt. 16.12.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

1. Themelohet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
   1.1 **Agim Miftari**, ing. i xehtarisë – sekretar dhe kryesues i komisionit,
   1.2 **Avdyl Feka**, ing. i bujqësisë - anëtar
   1.3 **Egzon Haradinaj**, ing. Arkitekturës - anëtar,
   1.4 **Shqipe Gashi,** ing. anëtare,
   1.5 **Betim Grabanica,** anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do të i kryej në pajtim me nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

3. Mandati i komisionit është 4 vjet nga dita e miratimit të këtij vendimi.

4. Lartësia e kompensimit për punë të këtij komisioni dhe komisioneve profesionale mund të bëhet me vendim të veçantë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe drejtoritë tjera sipas nevojës.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kryetarit të Komunës 02nr. 803/21, datë 19.07.2021.

7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi ju dërgohet:
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1662/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 19.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

**URDHËRESË**
**PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE**

1. Ndalohet ndezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike në vendet e hapura publike përkatësisht zona të banuara, rrugë trotuare, sheshe, tregje etj.

2. Ndalesa sipas pikës 1 të kësaj urdhërese vlen për periudhën nga data 21.12.2022 deri më 03.01.2023. Përjashtim bën data 31.12.2022 nga ora 23:00 deri 00:30 e datës 01 01.2023 (një orë e tridhjetë minuta).

3. Personat që bien në kundërshtim me këtë urdhëresë do të ndëshkohen sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

4. |Obligohet Drejtoria për inspektime – inspektorati kompetent për zbatimin e kësaj urdhërese.

5. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

Urdhëresa iu dërgohet:
- Drejtorisë për Inspektime
- Stacionit Policor në Vushtrri
- Në tabelën e shpalljeve të komunës
- Arkivit të Sekretarisë